



Ajet Kuranor:

Allahu i Madhërishëm thotë:

Adhuron Allahun dhe mos i shoqëroni Atij asgjë (në adhurim); silluni mirë me prindërit, të afërmit, jetimët, të varfrit, fqinjët e afërt dhe të largët, me atë që keni pranë,... [Kuran 4:36]

Hadith

I Dërguari i Allahut, paqja dhe lavdërimi i Allahut qofshin mbi të, ka thënë: “Aq shumë më këshilloi Xhibrili për fqinjin sa që mendova se do t’i japë të drejtë trashëgimie.” [Muttefekun alejhi]

Paralajmërim:

I Dërguari i Allahut, paqja dhe lavdërimi i Allahut qofshin mbi të, ka thënë: “Nuk më ka besuar ai njeri që fle i ngopur, ndërsa fqinji i tij i afërt është i uritur dhe ai e di këtë.”[\[1\]](#)

Ndriçim:

Nga Muxhahidi përcillet se familja e Abdullah ibën Omerit, Allahu qoftë i kënaqur prej tij, kishin prerë një dele. Kur erdhi Ibën Omeri në shtëpi i pyeti ata: “A i dhuruat diç nga ajo fqinjit tonë jehudi? A i dhuruat diç nga ajo fqinjit tonë jehudi?”[\[2\]](#)

Shkëputur nga libri: “Jeumijat saimeh” (Hakibetu saimat) – të autorëve dr. Adil Esh-Shiddi dhe
dr. Ahmed El-Mezjed

Përktheu: Jusuf H. Kastrati – Shembulli.com

[1] Këtë hadith e shënojnë Bezzari dhe Taberaniu, senedi i tij është “hasen”.

[2] Këtë e shënojnë Ebu Davudi dhe Tirmidhiu, ndërsa Albani e cilëson si “sahih”.